

POGRADEC

POP
2019

PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE

KONTRATA SOCIALE

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim



Rr. "Abdyl Frasheri"
Pallati 1/10, shk.1, ap.3 Tirane



+355 4 22 555 14



+355 68 20 59 301



gadc@gadc.org.al



www.popalbania.info



+355 4 22 555 14

Rreth Projektit

Përballja e Ofertave Politike – POP 2019, është një nismë e rrjetit të 11 organizatave të shoqërisë civile shqiptare në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme lokale të 30 Qershorit 2019.

POP 2019 synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien gjatë zgjedhjeve dhe periudhës pas tyre.

POP është zbatuar suksesshëm gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2013, Zgjedhjeve Lokale të vitit 2015 dhe Zgjedhjeve Parlamentare 2017. Kjo nismë është mbështetur dhe mbështetet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, me fonde të Ambasadës Suedeze në Tiranë.

POP 2019 do të organizohet në bashkitë Durrës, Fier, Kamëz, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë aty ku organizatat e rrjetit ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

POP 2019 synon:

Të nxisë dialogun mes zgjedhësve dhe kandidatëve, por edhe ndërmjet kandidatëve vetë, duke shërbyer si një platformë diskutimi, ku kandidatët do të mbahen të përgjegjshëm ndaj premtimeve të tyre dhe do të ftohen të nënshkruajnë Kontratën Sociale mes tyre dhe qytetarëve në çdo bashki.

Përmes mjeteve të avokimit / lobimit rrjeti POP 2019 do të përpiqet të arrijë rezultate, duke siguruar që kontratat sociale të mos jenë thjesht një zotim i shkruar, por një angazhim i vazhdueshëm për kryetarët e ardhshëm të bashkive.

Të informojnë qytetarët duke përdorur mediat sociale në lidhje me premtimet dhe përparësitë e kandidatëve dhe partive politike përkatëse si dhe në lidhje me punën që do të kryejnë të zgjedhurit për t'i përbushur ato. Përveç kësaj, faqja online interaktive, do t'u ofrojë qytetarëve shqiptarë një paraqitje shumë të nevojshme të ofertave të partive politike. Të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e të zgjedhurve gjatë fushatës elektorale, por edhe gjatë mandatit.

Aktivitetet që do të organizohen në kuadër të POP 2019, ofrojnë mundësi të paanshme dhe të barabarta për të gjitha palët dhe kandidatët në dhënien dhe paraqitjen e objektivave dhe platformave të tyre politike për qytetarët. Diskutimet midis kandidatëve nga parti të ndryshme nxisin politikanët të komunikojnë në mënyrë qytetare me njëri-tjetrin dhe synojnë të japin një shembull të mirë për publikun e gjerë në lidhje me kuptimin dhe mbështetjen që politikanët i ofrojnë komuniteteve të tyre pavarësisht bindjeve politike.

Në qendër të të gjitha aktiviteteve të POP 2019 do të jenë qytetarët me nevojat dhe shqetësimet e tyre, pasi zhvendosja e debatit publik nga politika drejt platformave politike në periudhën parazgjedhore është e rëndësishme. POP 2019 është një mundësi për partitë politike që të paraqesin programet e tyre të tregojnë se sa do të kujdesen për qytetarët në katër vitet e ardhshme. Premtimet e partive politike dhe programet e tyre do të monitorohen pas Zgjedhjeve Lokale 2019 nga Rrjeti i organizatave të POP 2019 dhe grupet e qytetarëve që do të organizohen nga ky rrjet.


ORGANIZATAT

- | | |
|--|--|
| • Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", Tiranë | • Intelektualët e Rinj "Shpresë", Shkodër |
| • Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës | • Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë |
| • Qendra Rinore Vlorë | • Qendra Rinore për Progres, Kukës |
| • ACPD/Qendra "Aulona", Vlorë | • Integrimi, Aktivizimi dhe Ndërgjegjësimi i të Rinjve, Pogradec |
| • Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz | • Lëvizja "Mjaft" |
| • Epoka e Re, Fier | |

PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE

Banorë të Bashkisë Pogradec u përfshinë në 6 Forume, të zhvilluara gjatë muajit mars 2019 me qëllim identifikimin e prioriteteve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej pesë Forumeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, si dhe studentë, shtëpiake apo persona të grupeve të marginalizuara.

Pjesëmarrja sipas gjinive



Në çdonjërin prej forumeve të zhvilluara qytetarët diskutuan gjerësisht mbi 21 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:



Shërbimet publike



Zhvillimi ekonomik vendor



Dimensioni social




Demokracia vendore

Për secilën prej 21 çështjeve objekt diskutimi ata dhanë këndvështrimin e tyre mbi gjendjen aktuale, si dhe diskutuan mbi prioritetet që në këndvështrimin e tyre duhet të përfshihen në axhendën e të zgjedhurve vendor.

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve prioritetet e komunitetit u organizuan në dy grupe:

1. **Ndërhyrje prioritare**, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. **Ndërhyrje disi prioritare**, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;



47 janë prioritetet e komunitetit të prezantuara gjerësisht në vijim, sipas shkallës së rëndësisë që i ka dhënë vetë komuniteti, për të cilat do të lobohet për të qenë pjesë e axhendës së të zgjedhurve të rinj vendor, sikurse përmbushja e të cilave do të monitorohet në vijim nga vetë komuniteti. Sipas forumeve me banorët të bashkisë Pogradec, rezultoi se të gjitha problematikat e ngritura ky komunitet i ka prioritare dhe kërkon nga bashkia ndërhyrje të menjëhershme.

PRIORITETET E KOMUNITETIT

● Grupi i parë / NDËRHJRJE PRIORITARE ●

Janë **11 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë shumë prioritare.

SHËRBIMET PUBLIKE  • Rrugët dhe trotualet • Ndriçimi • Pastrimi • Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet • Gjelbërimi	ZHVILLIMI EKONOMIK  • Planifikimi Strategjik • Mbështetja për fermerët • Nxitja e bizneseve • Nxitja e punësimit	DIMENSIONI SOCIAL  • Gratë • Grupe në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror¹
---	---	---

● Grupi i dytë / NDËRHJRJE DISI PRIORITARE ●

Për **10 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë disi prioritare.

SHËRBIMET PUBLIKE  • Transporti Publik • Pyjet dhe kullotat • Kanalet kulluese/vaditëse • Shkollat • Kopshtet dhe çerdhet	DEMOKRACIA VENDORE  • Informimi dhe komunikimi • Transparenca në vendimarrje • Pjesëmarrja në vendimarrje
ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR  • Mbledhja e të ardhurave dhe planifikimi i buxhetit	DEMOKRACIA VENDORE  • Komuniteti Rom dhe Egjiptian

¹ Në këto grupe përgjithësisht përfshihen: të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, familjet përfituese të ndihmës ekonomike, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, persona të pastrehë, fëmijët pa kujdes prindëror, përdorues të alkoolit apo drogave etj.

SHËRBIMET PUBLIKE

RRUGËT DHE TROTUARET

Banorët pjesëmarrës në forumet e organizuara në bashkinë Pogradec shprehen se cilësia e rrugëve është përmirësuar sidomos në rrugët kryesore të qytetit, por mbeten problematike rrugët periferike të qytetit, *"Duhet të shtohen më shumë trotuare sepse janë të ngushtë dhe duhet të ketë mirëmbajtje shumë më të madhe sidomos ato që nuk janë në qendër të qytetit."*² Ndërkohë që në njësisë administrative Buçimas rrugët janë të rregulluara dhe të mirëmbajtura, por e kundërta në Cërravë, ku banorët shprehen se vetëm në fshatin Blace rrugët janë të mira ndërsa në fshatra të tjera të kësaj njësie si Grabovicë apo Lumas, rrugët nuk janë cilësore dhe banorët shprehen shumë të pakënaqur duke e cilësuar si një prioritet të domosdoshëm.

Ndërkohë që po në Cërravë, rrugët që të çojnë në tokat bujqësore kanë marrë investime së fundmi. Ndërsa në njësinë administrative Hudenisht, banorët shprehen se 80 % e rrugëve të kësaj njësie janë të asfaltuara dhe të rregulluara, por kanë problem me rrugët bujqësore, të cilat nuk kanë hyrje dhe dalje dhe kështu sjellin problematika dhe pengesa për banorët e kësaj njësie. Ndërkohë që në njësinë administrative Trebinjë, sipas banorëve, *"infrastruktura rrugore nuk ka patur investim prej shumë vitesh dhe gjendja është shumë e mjerueshme"* dhe po njësoj shprehen edhe banorët e njësisë administrative Proptisht.

Prioritet 1: Adresimi i problematikës për investime në infrastrukturë për shtrimin e rrugëve të njësive administrative Trebinjë, Velçan, Dardhas dhe Proptisht.

Prioritet 2: Rregullimi i rrugëve në fshatrat Grabovica dhe Lumas në njësinë administrative Cërravë.

Prioritet 3: Rregullimi dhe shtrimi i rrugëve që të çojnë në tokat bujqësore në njësitet administrative të bashkisë Pogradec.

NDRIÇIMI

Komuniteti i bashkisë Pogradec, në takimet dhe forumet e organizuara nxorën në pah edhe mungesën e ndriçimit në shumë zona të njësive të ndryshme administrative. Në Cërravë ky shërbim është funksional vetëm në qendër ndërkohë që nëpër lagje ka mungesa të theksuara. Në Buçimas ky shërbim njësoj si rrugët është përmirësuar dhe ofrohet në mënyrë cilësore.

Ndërkohë që në qytet, megjithëse është bërë një punë e mirë dhe ndriçimi në pjesën më të madhe është cilësor, ka akoma disa zona që ndriçimi mungon totalisht.

Prioritet 4: Adresimi dhe rregullimi i shërbimit të ndriçimit në njësitet administrative.

PASTRIMI

Në forumet e rajoneve të qytetit të Pogradecit situatën e pastrimit e vlerësojnë më të përmirësuar krahasuar me vite më parë, megjithatë pjesëmarrësit në forume mendonin se ka ende nevojë për përmirësim sidomos në rritje të frekuencës së mbledhjes së mbeturinave. Shtimi i koshave për mbledhjen e mbeturinave në disa zona të qytetit, veçanërisht gjatë sezonit turistik, monitorimi më i mirë i pastrimit të firmave kontraktore veçanërisht në zonat ku infrastruktura rrugore nuk është shumë e mirë.

Pjesëmarrësit në forumet e Cërravës janë shprehur përgjithësisht të kënaqur me cilësinë e pastrimit, por theksojnë se është i nevojshëm shtimi i koshave për mbledhjen e mbeturinave. Gjithashtu banorët e kësaj njësie ngritën si problematike hedhjen e mbetjeve, sidomos atyre plastike në lumin e fshatit nga vetë banorët. Në Hudenisht pastrimi dhe mbledhja e mbetjeve bëhet dy herë në javë por nuk ka vend-depozitime për mbledhjen e tyre kështu që banorët i nxjerrin tek dyert e shtëpive dhe makina kalon dy herë në javë. E njëjta situatë paraqitet edhe në njësinë administrative Buçimas. Për pjesëmarrësit në Forumin e Njësive Administrative Trebinjë pastrimi mbetet një problem shumë i mprehtë. Në fshatra nuk ka vendgrumbullime për mbeturinat, aty mungojnë kontenitorët dhe koshat. *"Nuk ka asnjë lloj pastrimi, banorët i asgjesojnë vetë mbetjet e tyre. Ka mungesa të koshave edhe nëpër fshat por edhe pranë institucioneve."*³ – thanë banorët.

Prioritet 5. Shtimi i frekuencës së pastrimit dhe koshave në njësitet administrative të bashkisë Pogradec dhe qytetit. Gjendja fizike e kontenierëve ekzistues kërkon përmirësim dhe shtim të numrit në të gjithë qytetin. Përmirësim i cilësisë së pastrimit sipas nevojave të secilës njësi:

Rajonet e qytetit Pogradec. Shtimi i punonjësve të pastrimit dhe shtimi i koshave në disa zona të qytetit, sidomos gjatë sezonit turistik.

Cërravë, Proptisht. Vendosja e koshave për mbledhjen e mbeturinave në çdo fshat.

Hudenisht, Buçimas dhe Proptisht. Krijimi nga ana e pushtetit lokal të vend-depozitimeve të mbetjeve.

Trebinjë. Adresimi i problematikës disa vjeçare të kësaj njësie administrative. Bashkia të kontraktojë firmë pastrimi ose nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të vendosë kosha për mbledhjen e mbeturinave në të gjitha fshatrat. Mbledhja sistematike e mbeturinave nga makinat e pastrimit në të gjitha fshatrat e kësaj njësie.

SHËRBIMET PUBLIKE

FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM DHE KANALIZIMET

Furnizimi me ujë të pijshëm në përgjithësi është 24 orë, sidomos në rajonet e qytetit, dhe Buçimas, por banorët e këtyre zonave ankohen për taksën e lartë të vendosur mbi ujin e pijshëm dhe kërkojnë kështu uljen e tarifave. Ndërkohë që në Cërravë, uji i pijshëm është një problem i madh për banorët, sepse sipas tyre *"furnizimi me ujë është me orare të caktuara dhe mban shumë pak,"* dhe banorët e kanë zgjidhur vetë këtë problematikë duke hapur puse në çdo familje.

Edhe në Hudenisht banorët shprehen se të gjitha fshatrat e kësaj njësie administrative kanë probleme me ujin e pijshëm duke qenë se rrjeti është komplet i amortizuar. Në të njëjtën linjë janë edhe banorët e Trebinjës, të cilët deklarojnë se në këtë njësi administrative nuk ka rrjet të mirëfilltë për ujin e pijshëm dhe banorët e sigurojnë duke u furnizuar në burime natyrore.

Edhe përsa i përket kanalizimeve banorët e bashkisë Pogradec thonë se ato nuk egzistojnë dhe derdhjet e ujërave të zeza i kanë pranë lumenjve dhe përrenjve të zonës.⁴ Në disa fshatra të njësisë administrative Cërravë, si në Leshnicë dhe Blace, përdorin akoma gropat septike.⁵

Prioritet 6: Adresimi me prioritet i investimeve për rrjetëzimin e furnizimit me ujë të pijshëm për secilën prej njësive administrative të bashkisë Pogradec.

Prioritet 7: Adresimi me prioritet i investimeve për shtrirjen e kanalizimeve të ujërave të zeza në të gjithë bashkinë Pogradec.

GJELBËRIMI

Zgjerimi i hapësirave të gjelbërta në qytetin e Pogradecit u konsiderua shumë i rëndësishëm nga pjesëmarrësit e forumeve të rajoneve të këtij qyteti. Pjesëmarrësit vlerësuan se investimet në gjelbërim janë bërë vetëm në zonën e liqenit dhe kërkojnë që ky shërbim të shtrihet në të gjithë qytetin.

Ata e konsiderojnë të rëndësishëm ndërhyrjen për gjelbërim në rrugët dytësore të qytetit. *"Në qytet ka më shumë beton sesa gjelbërim, kërkojmë të rikthehet qyteti i luleve"* shprehen banorët e Pogradecit.

Prioritet 8. Zgjerimit i hapësirave të gjelbra dhe veçanërisht ndërhyrje për gjelbërim në rrugët dytësore të qytetit.

Prioritet 9: Shtimi i këndeve të lojrave për fëmijë pasi janë vetëm 2 të tilla dhe ato nuk plotësojnë asnjë standard minimal.



● ZHVILLIMI EKONOMIK ●

PLANIFIKIMI STRATEGJIK

Në përgjithësi, pjesëmarrësit në forume në bashkinë Pogradec shprehen se nuk kanë dijeni apo informacion në lidhje me plane apo programe konkrete të kësaj bashkie që ndikojnë në zonat ku ata banojnë. Në Cërravë, komuniteti merr informacion nga administratori i njësisë për planet e kësaj njësie, por shprehen se nuk njohin të detajuar përmbajtjen konkrete të tyre. Edhe në Trebinjë, Buçimas, Hudenisht dhe qytet ka mungesë të theksuar informacioni në lidhje me planet për këto njësi.

Prioritet 10: Informimi i komunitetit në lidhje me planet apo programet konkrete për zhvillimin e njësive administrative pranë kësaj bashkie.

MBËSHTETJA PËR FERMERËT

Në forumet e Njësive Administrative të Buçimasit, Trebinjës, dhe Hudenishtit pjesëmarrësit nxorrën në pah mungesën e informacionit përse i përket programeve për mbështetjen e fermerëve. Një njësinë administrative Buçimas dhe Trebinjë banorët nuk e njohin agronomin apo veterinerin dhe asnjëherë nuk kanë marrë shërbim këshillimi për bujqësinë. Ndërkohë që në njësinë administrative Cërravë, banorë u shprehën se këshillat mbi bujqësinë i marrin nga agronomi i kësaj njësie dhe shërbimet për gjënë e gjallë i marrin në mënyrë të rregullt nga veterineri i zonës. Zhvillimin e programeve për mbështetjen e fermerëve, sikurse dhe përfundimin e procesit të menaxhimit të tokave ata e konsiderojnë si çështje prioritare.

Prioritet 11: Informimi i fermerëve në lidhje me shërbimet e këshillimit për bujqësinë nga ana e pushtetit vendor.

Prioritet 12: Adresimi i mungesës së agronomit dhe veterinerit për çdo njësi administrative.

Prioritet 13: Zhvillimi i programeve për mbështetjen e fermerëve

NXITJA E BIZNESEVE

Pjesëmarrësit në forumet e rajoneve të qytetit të Pogradecit nuk kishin asnjë informacion në lidhje me strategji, politika apo plane për nxitjen e biznesit privat. Ata shprehen se e dinë që egzistojnë disa lehtësi fiskale për nxitjen e biznesit, që i kanë dëgjuar, por saktësisht nuk e dinë për çfarë bëhet fjalë. Edhe në lidhje me punën e bashkisë në këndvështrimin e nxitjes së bizneseve për krijimin e vendeve të reja të punës, banorët e forumeve në Pogradec u shprehën se *"nuk e dimë çfarë bën bashkia."* Njësoj, edhe për nxitjen e bizneseve të të rinjve apo grave, informacioni mungon totalisht.

Për bizneset që drejtohen nga gratë bashkia ofron një ulje të taksave vendore, por kur ju çojnë taksat për t'i paguar kjo ulje nuk reflektohet.

Prioritet 14: Informimi i komunitetit në lidhje me planet e bashkisë për nxitjen e biznesit privat dhe zbatimin e lehtësimit të taksave për biznese që udhëhiqen nga gratë.

Prioritet 15: Zhvillimi i programeve në lidhje me nxitjen e biznesit nga të rinjtë dhe/apo gratë. Parashikimi në buxhet për krijimin e një fondi "start up" për të rinjtë.

NXITJA E PUNËSIMIT

Pjesëmarrësit në forumet e rajoneve të qytetit të Pogradecit shprehen se shtresat sociale që e vuajnë më shumë papunësinë janë banorët e zonave rurale, komuniteti rom dhe të rinjtë. Ata nuk ishin të informuar për egzistencën e programeve specifike të zhvilluara nga Bashkia për nxitjen e punësimit dhe as të egzistencës së një strukture specifike në Bashki të angazhuar për këtë çështje. Në këndvështrimin e tyre ata ishin vetëm në dijeni të egzistencës së Zyrës së Punës e Shërbimit Kombëtar që Punësimit.

Banorët nuk kishin informacion për programe të veçanta të bashkisë për nxitjen e punësimit të të rinjve, grave, apo grupeve në nevojë, gjithashtu e vlerësonin shumë të dobët punën e bashkisë në këndvështrimin e nxitjes së punësimit.

Prioritet 16: Fushata ndërgjegjësuere të ndërmarra nga bashkia për informimin e komunitetit në lidhje me programet për nxitjen e punësimit.

Prioritet 17: Krijimi i Programeve të Bashkisë-Internship me pagesë- për nxitjen e punësimit në përgjithësi por edhe programe të veçanta që prioritojnë grupet më pak të avantazuara në tregun e punës dhe në fokus të veçantë të kenë gratë dhe të rinjtë

Prioritet 18: Krijimi i Marrëveshjes publik- privat për krijimin e programit për nxitjen e punësimit për të rinjtë të orientuar drejt një profesioni.

DIMENSIONI SOCIAL

GRATË

Banorët e bashkisë Pogradec shprehen se bashkia nuk ka programe specifike për parandalimin e dhunës ndaj grave, por ka organizata jo-fitimprurëse që janë aktive dhe ofrojnë programe dhe shërbime për këtë kategori⁶. Gjithashtu banorët pjesëarrës në forume u shprehën se ka patur disa fushata ndërgjegjësimi kundër dhunës ndaj gruas por më së shumti këto fushata janë ndërmarrë nga OJF-të dhe më pak nga bashkia.

Banorët shprehen se përfaqësimi i grave në administratën e bashkisë Pogradec është i konsiderueshëm si dhe pjesëmarrja e tyre (grave) në këshillin bashkiak gjithashtu, por ata shprehen se: *"përfaqësimi i grave nuk ka shumë peshë sepse zëri i tyre nuk dëgjohet."*

Prioritet 19: Zgjerim i programeve ndërgjegjësuere dhe informuese që targetojnë komunitetin mbi dhunën në familje dhe pasojat e saj. Sidomos informimi në njësitë administrative të bashkisë për këtë çështje.

GRUPE NË NEVOJË PËR SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR

Në pesë forumet e zhvilluara në rajonet e bashkisë Pogradec, pjesëmarrësit ishin shumë pak të informuar mbi egzistencën e shërbimeve të kujdesit shoqëror që funksionojnë në territorin e Bashkisë, dhe u shprehën se nevojat për këto shërbime janë shumë të mëdha dhe prioritare. Sipas tyre, bashkia duhet të mbështesë me shërbime kategori të ndryshme në rrezik dhe me prioritet të ndërtojë shërbime psikologjike dhe aftësim për jetën sidomos për të rinjtë.

Në mënyrë të veçantë në forumet e këtyre njësive administrative u theksua mungesa e shërbimeve në familje për personat me aftësi të kufizuara, si dhe e shërbimeve psikologjike për viktimat e dhunës në familje. Pjesëmarrësit në forumet e organizuara në rajonet e qytetit, vlerësonin si shumë prioritare ngritjen e programeve të veçanta nga bashkia në lidhje me parandalimin e dhunës ndaj grave, duke qenë se ka vetëm një qendër emergjence e cila nuk e përballon dot fluksin dhe duhet punuar më shumë për të mbështetur këtë kategori të grave. Sipas banorëve, në këtë qendër ka mungesë personeli, mungesë financiare për ushqim etj

Prioritet 20: Rishikimi i anës financiare të qendrës së emergjencës në lidhje me përmbushjen e nevojave që kjo qendër ka.

Janë OJF-të që operojnë në këtë bashki të cilat ofrojnë mbështetje me shërbime për viktimat e dhunës në familje (shërbime këshillimi dhe mbështetje psiko-sociale falas për vajzat dhe gratë që pësojnë dhunë në familje ndaj mbështetja financiare nga ana e bashkisë për të financuar organizatat të cilat e kanë ekspertizën për të dhënë këto shërbime është një prej kërkesave të komunitetit.

Prioritet 21: Parashikimi në buxhet për mbështetje financiare nga ana e bashkisë për OJF-të që ofrojnë shërbime falas për vajzat dhe gratë e dhunuara. .

Prioritet 22: Shtimi i qendrave në mbështetje të grupeve në nevojë.

Çështje të tjera të bashkisë Pogradec që qytetarët i kanë listuar si shumë prioritare:

Prioritet 23: Biblioteka e qytetit (rikonstruksion dhe shtimi i fondit të librit)

Prioritet 24: Ngritja e një Qendre Rinore

Prioritet 25: Rikonstruksion i Pallatit të Kulturës

Prioritet 26: Plan strategjik për zhvillimin e peshkimit

Prioritet 27: Promovim i turizmit katër stinor.



● SHËRBIMET PUBLIKE ●

TRANSPORTI PUBLIK

Në lidhje me transportin publik banorët pjesmarrës në forumet e bashkisë Pogradec kanë nxjerrë në pah se në zona të ndryshme të njësive të ndryshme të njësive administrative ai egziston dhe është funksional. Në përgjithësi transporti ofrohet dhe sigurohet nga bashkia për nxënësit e shkollave 9-vjeçare⁷, por banorët shprehen se mungon siguria tek shoferët, të cilët sipas tyre nuk janë të rregull me dokumenta apo me sigurinë e mjeteve.⁸

Prioritet 28: Adresimi dhe kontrolli nga ana e bashkisë e mjeteve të vëna në dispozicion për transportimin e nxënësve të shkollave 9-vjeçare.

Prioritet 29: Vendosja e transportit për linjën Lin – Tushemisht, në sezonin e verës.

PYJET DHE KULLOTAT

Në lidhje me pyjet dhe kullotat, banorët e rajoneve të forumeve të organizuara pranë zonave rurale u shprehën se drutë për ngrohje i blejnë në vendgrumbullime por që çmimi i tyre është shumë i lartë. Ndërkohë një pjesë e banorëve të njësive administrative Cërravë u shprehën se i sigurojnë vetë në pyjë pa i blerë. Ndërsa në lidhje me kullotat e bagëtive në Hudënisht banorët i kanë blerë dhe po njësoj edhe në njësitë e tjera të bashkisë Pogradec. Banorët e Trebinjës u shprehën se kullotat po provatizohen çdo ditë, për shkak të rrugës kryesore e cila sipas tyre në një të afërme të afërt do të sjellë zhvillim në zonën e tyre. Ndërkohë në lidhje me masat për parandalimin e zjarreve në pyje dhe kullota banorët treguan se ka grupe gadishmërie në çdo zonë dhe nuk kanë patur problematika.

Prioritet 30: Adresimi i çmimit të lartë të drurëve të zjarrit dhe ndërhyrja e bashkisë për uljen e çmimit.

Prioritet 31: Vendosja e kontrolleve nga ana e bashkisë për parandalimin e prerjeve pa kriter të drurëve për zjarr.

KANALET KULLUESE/VADITËSE

Konstatohet vëmendje e shtuar e bashkisë për ndërtimin apo mirëmbajtjen e kanaleve kulluese, megjithatë jo në të gjitha njësitë administrative të Pogradecit. Në Forumin e njësive administrative Buçimas u theksua se kanalet kulluese egzistojnë vetëm në fshat Starovë, Guras, Zdervask kurse kanalet vaditëse mungojnë në çdo fshat të kësaj njësie administrative.

Ndërsa në Cërravë, pas premtimeve nga ana e bashkisë para katër vjetësh, së fundmi kanë marrë investim dhe janë betonizuar. Ndërkohë në Hudënisht, kanalet kulluese/vaditëse egzistuese mirëmbahen nga vetë banorët dhe po njësoj edhe në njësinë administrative Trebinjë.

Prioritet 32: Ndërtimi i kanaleve kulluese në të gjitha njësitë administrative rurale ku mungojnë.

Prioritet 33: Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së kanaleve kulluese/vaditëse në Hudënisht dhe Trebinjë.

SHKOLLAT

E përbashkëta e pothuajse të gjitha forumeve të zhvilluara në bashkinë Pogradec është fakti që banorët nuk kërkojnë ndërtimin e shkollave të reja, duke qenë se sipas tyre ato ekzistueset janë të mjaftueshme për numrin e nxënësve në çdo njësi administrative. Por ata shprehen se rikonstruktimi i egzistuesve është shumë i nevojshëm, problematikë kjo e ngritur nga pjesa më e madhe e banorëve. Ndërsa në Cërravë banorët thonë se kanë disa shkolla 9-vjeçare por problem mbetet numri i ulët i nxënësve. Ndërkohë në shkollat e qytetit problematikat janë të mëdha. Sipas banorëve pjesëmarrës në forume shkollat kanë nevojë jo vetëm për rikonstruktion por edhe për palestra dhe bazë materiale. Gjithashtu kërkohet ndërtimi i shkollave të reja sepse mësimi bëhet me dy turne. Ndërkohë banorët e Trebinjës kërkojnë ngritjen e infrastrukturës në shkolla për nxënësit me aftësi ndryshe.

Prioritet 34: Ndërhyrja dhe rikonstruktimi i shkollave egzistuese në Trebinjë, Buçimas, Hudënisht, Cërravë dhe Pogradec.

Prioritet 35: Adresimi për ndërtimin e shkollave të reja në qytetin e Pogradecit dhe ndërtimi i palestrave dhe pajisja me bazë materiale në shkollat egzistuese.

Prioritet 36: Rregullimi i infrastrukturës për nxënësit me nevoja të ndryshme në Trebinjë.

SHËRBIMET PUBLIKE

KOPSHTET DHE ÇERDHE

Banorët e bashkisë Pogradec kanë mungesa për kopshte dhe çerdhe për fëmijët por edhe nevojë për mirëmbajtjen e atyre egzistuese. Banorët e Cërravës u shprehën se numri i kopshteve është i mjaftueshëm dhe se për çerdhe nuk i kanë të nevojshme në këto zona. Ndërkohë që në njësinë administrative Cërravë, fshatrat Lumas, Leshnicë dhe Nishavec kanë nevojë për kopshte. Në Hudenisht prioritet mbetet mirëmbajtja e atyre egzistuese.

Ndërkohë në Trebinjë banorët kërkojnë me patjetër ngritjen e një kopshti, duke qënë se ai egzistuesi është në një nga klasat e shkollës në katin e parë. Në vijim, banorët e qytetit të Pogradecit kanë nevojë për kopshte të reja dhe sidomos për çerdhe të re, sepse aktualisht për të gjithë qytetin egziston vetëm një çerdhe e cila nuk është e mjaftueshme për të përballuar nevojat.

Prioritet 37: Mirëmbajtja e kopshteve dhe çerdheve egzistuese në të gjitha njësitet administrative të Pogradecit.

Prioritet 38: Adresimi për ngritjen e një kopshti fëmijësh në Trebinjë.

Prioritet 39: Adresimi për ngritjen e kopshteve dhe patjetër të një çerdhe në qytetin e Pogradecit.

Prioritet 40: Objektet sanitare mungojnë (ekziston vetëm një në breg të liqenit), problematikë kjo sidomos në sezonin turistik kur ka edhe shtim të numrit të popullsisë, prandaj prioritet për qytetarët është shtimi i tyre.

DEMOKRACIA VENDORE

INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Pjesëmarrësit në forumet e organizuara në bashkinë Pogradec shprehën se dokumentat merren lehtësisht dhe në kohë reale sipas llojit të informacionit për të cilin kanë nevojë. Ndërkohë që në Cërravë banorët shprehën se problem mbetet gjendja civile dhe aplikimi i kartës së identitetit, për të cilin banorët duhet të shkojnë në njësinë administrative në

Buçimas për të marrë shërbimin, i cili zgjat disa ditë për shkak të fluksit të banorëve të dy njësive administrative. Ndërkohë që banorët e qytetit të Pogradecit shprehën se marrja e informacionit dhe e dokumentave pranë bashkisë merren me shumë vonesa. *"Tek zyra e informacionit në bashki ka shumë vështirësi, ka raste që ka edhe probleme komunikimi mes qytetarëve dhe punonjësve."*⁹ Ata shtuan gjithashtu se ka raste që informacioni nuk merret në kohë reale si p.sh mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Prioritet 41: Adresimi dhe zgjidhja e problematikës së banorëve të Cërravës për pajisje me kartat e identitetit në njësinë e tyre administrative.

Prioritet 42: Rritja e informimit dhe adresimi i përmirësimit të komunikimit mes qytetarëve dhe punonjësve të bashkisë në zyrat e informacionit dhe jo vetëm.

TRANSPARENCA NË VENDIMMARRJE

Banorët e bashkisë Pogradec shprehën se të gjitha njësitet administrative kanë kënde informimi për komunitetin, kënde të cilat rinovohen në mënyrë të rregullt.

Ndërkohë që banorët e qytetit shprehën se edhe pse bashkia ka një faqe interneti, kur ata shkruajnë për problematika të ndryshme nuk marrin përgjigje.

Prioritet 43: Komunikimi interaktiv i punonjësve të bashkisë me banorët e bashkisë Pogradec.

PJESËMARRJA NË VENDIMMARRJE

Banorët e njësive administrative Buçimas, Cërravë, Hudenisht dhe Trebinjë shprehën se ata janë pjesë aktive e takimeve të organizuara, por kërkesat e tyre nuk marrin zgjidhje apo buxhet. Kryepleqtë janë aktiv në çdo fshat të njësive administrative, por sipas banorëve të Buçimasit ata (kryepleqtë) kërkojnë rritje page.

Ndërkohë banorët e qytetit shprehën se nuk marrin njoftime në kohë reale për pjesëmarrje, megjithëse e dinë p.sh që mbledhjet e këshillit bashkiak janë të hapura për publikun. Gjithashtu banorët shprehën se mendimet e tyre nuk merren parasysh dhe nuk ndjehen si pjesë e vendimmarrjes.

Prioritet 44: Ngritja e mekanizmave dhe procedurave për informimin e komunitetit në kohë reale.¹⁰

Prioritet 45: Buxhetim me pjesëmarrje në mënyrë që qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrjen mbi menaxhimin e financave publike të pushtetit lokal.

● ZHVILLIMI EKONOMIK ●

MBLEDHJA E TË ARDHURAVE DHE PLANIFIKIMI I BUXHETIT

Banorët e bashkisë Pogradec informacionin mbi taksat e marrin në kohë dhe janë taksapagues të rregullt por ankohen se ato (taksat) janë të larta krahasuar me shërbimin që marrin.

Prioritet 46: Balancimi i shërbimeve me taksat që komuniteti paguan.



● DIMENSIONI SOCIAL ●

KOMUNITETI ROM DHE EGJIPTIAN

Sipas banorëve, bashkia ka program të veçantë për këtë target grup por më shumë duhet të bëhet në lidhje me përfshirjen e tyre sociale.

Prioritet 47: Zgjerimi dhe rritja e programeve për komunitetin Rom dhe Egjiptian.





**PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE**

